

# **STATUTI DHE AKT THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE**

## **"Vilson Plastik Shpk"**

Sot me date 05/08/2021 Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise, ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit" , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Per shoqerite tregatre" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi nga ortaku i vetem :

Znj. Myrvete Haxhiu lindur me date 13/02/1963 ne Fushe - Kruje, banuese ne Tirane, mbajttese e kartes se identitetit me nr. ID G35213031E, vendosi te krijojte shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Vilson Plastik " me akt themelimi si vijon :

### **Formulimi**

#### **Neni 1**

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur "Vilson Plastik ". Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline shoqeria . Shoqeria do te ushtrje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

### **Selia e Shoqerise**

#### **Neni 2**

Selia e shoqerise "Vilson Plastik " do te kete seline ne rrugen "Rruga "Qemal Stafa ",pallati nr.11, shkalla 3, Tirane. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijojte filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese se ortakeve.

### **Objekti I Veprimtarise**

#### **Neni 3**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e perpunimit te pipave plastike duke u furnizuar me lende te pare nga jashte vendit dhe duke e perpunuar ate. Sherbimi do te kryhet ne perputhje me cdo ligj te zbatueshem dhe rregullore.



VILSON HAXHIU  


## Kohegzjatja e Shoqerise

### Neni 4

Kohegzjatja e shoqerise do te jete me nje afat 20-vjecar . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku .

## Kapitali I Shoqerise

### Neni 5

Kapitali fillestar I shoqerise private "Vilson Plastik " do te jete 100.000 LEKE (Njeqind mije leke ). Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakut te vetem Znj. Myrvete Haxhiu , e ndare ne 1 kuota . Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet ( por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar ).

## Drejtimi I Shoqerise

### Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori I saj , I cili me vendim te ortakeve do te jete Z.Vilson Haxhiu, lindur ne Kruje me date 04/08/1993 mbajtes I kartes se identitetit nr. Id J30804057J me nje afat te percaktuar 5 vjecar. Ai eshte perfaqesuesi I Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj . Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues I pajisur me prokure te posacme .

### Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise I takojne ortakeve te shoqerise.

### Neni 8

Ortaket themelues kane te drejten te emerrojne dhe administratore te tjere te vlerave materiale financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortak me nje vendim te asamblese se ortakeve me ane te vendimit te asamblese se ortakeve.

### Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Tirane .

### Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

Ortaku i vetem  
Myrvete Haxhiu



ADMINISTRAT  
VILSON HAXHIU

